

“Mjaft” po na mëson demokracinë

[Shqip, 8.4.2006, me titull “Leksione demokracie brenda një jave”]

Po vazhdojnë të na japin mësimet e demokracisë ata të rinjtë simpatikë të lëvizjes Mjaft. Janë të parët që u organizuan në protestë në mbrojtje të demokracisë së brendshme të partisë në pushtet—shumë “nga të vjetrit” u çuditën. Të gjithë, përfshirë dhe analistët e opinionistët e masmediave, duhet të bashkohen me të rinjtë e Mjaft, në mbrojtje të ligjit, në ruajtje të demokracisë së brendshme të një partie politike, e, ç’është më kryesorja, të partisë që është në pushtet. Përdhunimi i demokracisë, flakja antistatutore e një deputeti, duhet të jetë jo vetëm problem i të gjithëve, por edhe i organeve kompetente shtetërore.

Jeta e brendshme e partive dhe ligji

Çdo shoqëri, edhe jona, duhet të kujdeset që të mbajë të pastër dhe në zbatim të rregullave bazë të demokracisë, partitë politike. Partitë politike janë djepet ku rriten kryeministrat, ministrat, deputetë e të gjithë autoritetet që udhëheqin vendin. Edhe në legjislacionin shqiptar, është shprehur kujdesi për jetën e brendshme të partive politike. Në ligjin “Për Partitë Politike”¹ shkruhet se ndalohet një parti kur *“organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtarit për të zgjedhur e për t’u zgjedhur”*. e më tej thuhet se ndalohen partitë që *“mbështetet në metoda totalitariste”*. Pra ligji është i qartë, e nuk ka vend për keqinterpretime.

Forumet e PD-së, të paralizuar

Ka vite që brenda PD-së shkelen parimet elementare të demokracisë. Kryeministri aktual ka kohë që e ka kthyer PD-në në një parti totalitariste, ku është kryetari që vetë vulos e vetë firmos. Forumet e partisë në PD, janë krejt formale. Atyre, nuk u lihet as koha e duhur për të marre vendime, dhe në shumë raste anashkalohe fare, siç qe dhe rasti i fundit me deputetin Ngjela. I vetmi “forum” që punon në PD, është ai i kryetarit të saj, kryeministrit aktual. Edhe forumet e sajuara prej tij, si “kryesia e vogël”, thjeshtë i shërbejnë kryetarit si këshillëtarë personalë që i thëret e i shpërndanë kur do vetë e si do vetë. E forume të tilla të sajuara, ka shumë të tjera si “miqt e kryeministrit”, “telefonuesit e kryeministrit” etj., që kanë asfiksuar dhe eklipsuar krejtësisht forumet statutore të PD-së.

Analistët dhe dhuna autokratike në PD

Rasti i deputetit Ngjela është thjeshtë rasti i fundit, dhe që si rezultat i regjistrimit të bisedës dhe bërjes publike të këtij regjistrimi, iu dha mundësi të gjithëve, të marrin vesh në mënyrë spektakolare, se ç’ndodh në të vërtetë në këtë parti. Por ka me dhjetra njerëz që brenda PD-së, dhe edhe publikisht, gjatë këtyre 15 vjetëve kanë luftuar për ruajtjen e demokracisë së PD-së—por “janë harruar”, apo “janë keqinterpretuar”, apo janë etiketuar “me mëllëfe personale” etj., apo u është kërkuar perfeksioni, “e vërteta ideale”, duke anashkaluar kësajsoj perversitetin real e të rrezikshëm të kryesorit, të atij që sot u riciklue në kryeministër. Shpesh analistët shijojnë vetëm atë që u futet direkt në gojë, pa kërkuar më tutje. Në se do të kishin qenë

me kohë më të vëmendshëm, gjërat do të ishin ndryshe—nejse, edhe analistët nuk janë imunë nga sëmundjet që ka shoqëria shqiptare aktuale, bile janë pjesë e saj.

Por le të shkëputemi nga personalizimet e të mbetemi tek fenomeni. Po bëhet mirë që po evidentohet nga mjaft analistë, ky rasti i fundit. Ndër kohë, është e mjerueshme heshtja, e aq më keq justifikimet për kryeministrin, nga shumë analistë të tjerë, travestiti (që kanë ndërruar lëkurën duke u kthyer në “sazexhinjë të kryeministrit”); këta po bëjnë diversione me “gjëra personale të deputetit Ngjela”, duke synuar largimin e vëmendjes së publikut nga fenomeni kryesor: dhuna autokratike brenda PD-së.

Partitë e tjera

Partitë e tjera politike, qofshin aleate apo opozitare me PD-në, duhet ta konsiderojnë detyrë të tyre rivendosjen e demokracisë brenda PD-së. Lufta kundër shkeljes së ligjit, aq më tepër kur kjo shkelje ndodh brenda një partie të madhe, duhet të zërë një pjesë të konsiderueshme të aktivitetit të tyre. Konkretisht, e ka shumë gabim kryetari i PS-së, që deklaron me të madhe se qenka “problem i brendëshëm i PD-së”, e që ai “nuk merret me ta”. Jo, ai bën mirë të merret, dhe bile shumë, se duke u përpjekur të demokratizohet PD-ja, do të bënte një rrugë e dy punë: do të kontribuonte edhe për demokratizimin e PD-së, por edhe të partisë së vet, që edhe ajo është në rrezik të epidemisë së autokracisë së brendshme!

Gjykata Kushtetuese

Por edhe organet e shteti duhet të ndërhyjnë që të rivendoset demokracia në PD. Bile ndërhyrja e shtetit është me efekt të menjëhershëm, ndërkohë që shpesh duhen pritur zgjedhjet e radhës, që të korren frytet e punës së të tjerëve të përmendur më lart, sepse i vetmi mjet detyrues i tyre është vota e njerëzve. Shteti mund të përdorë “menjëherë” edhe dhunën e ligjit, pa pritur zgjedhjet. Ligji² thotë: “*Konstatimi i veprimtarisë antikushtetuese të partisë politike dhe ndalimi i saj vendoset nga Gjykata Kushtetuese*”. Do t’i sygjeronim lëvizjes Mjaft, ta drejtojë protestën e saj jo vetëm nga faktori kryesor i prishjes së demokracisë në PD, kryeministri aktual, por edhe nga gjykata Kushtetuese, si një organ i shtetit, i cili duhet të marrë masa, deri në ndalimin e PD-së, në se në të nuk rivendoset demokracia e brendëshme.

Dakord, kjo e fundit tingëllon utopi, shumë teorike, shumë larg realitetit shqiptar, por së paku ta dimë se ky është ligji!

Bashkim Kopliku

Durrës, më 7.3.2006

¹ neni 7 i ligjit Nr.8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike”

² neni 8 i po të njëjtit ligj.